

Falënderimi dhe takon vetëm All-llahut, subhaehu ve teala, salavatët dhe selamet qofshin mbi Pejgamberin tonë, Muhammedin, salall-llahu alejhi ve selem, që pas tij nuk ka më të dërguar, mbi familjen e tij, mbi shokët e tij dhe të gjithë ata që e pasojnë dhe do ta pasojnë deri në Ditën e Gjykimit.

Ishte ëndërra ime që këmba të shkelë në hapësirën e univerzitetit. Me dëshirë të madhe shpresoja të vijë momenti ku unë të bëhem studente. Do isha e lumtur me këtë fat të madh, me të cilin një studente do të fitonte një autoritet.

Kurse sa i përket jetës sime fetare, isha shumë e mangët; nuk i kushtoja kujdes namazit e as adhurimeve të tjera. Megjithatë, isha e kënaqur më këtë jetë fetare. Besimtarët e mirëfilltë i shikoja me syrin nënçmues. Tek unë ishin njerëz të prapambetur. Tek ata është e papranueshme çdo gjë që është bashkohore, çdo gjë që është e re. Ndërkohë, gjithnjë bija dakord me mendimet që kishin qëndrime pelësuese, të cilat i dëgjoja nga disa dijetarë që vazhdimisht dilnin në kanale satelitore. Madje, këto ishin justifikim i gabimeve dhe keqtrajttimeve të mia.

Isha mërzhitur më me urdhërat, ndalesat, të cilat nuk na u ndanin në shkollë. Dëshiroja të kem një liri më të plotë. Në univerzitet do të veshi ç'të dua, do veproj ç'dua. Mjaft më u ngushtova më këshillat dhe gjykimet e mësuesve: Mos vish këtë rrobë, assesi mos vish robe të shkurta, hiqe nga fytyra këtë kozmetikë.

Për njeriun është të orvatet deri që të arrijë pikësynimet e tija. Po, unë do t'i arrijë pikësynimet e mia... Gjithnjë mendoja, me padurim prisja ditën kur do t'i jap fund këtyre prangave. Dua të bëhem femër me qëndrime, dëshira dhe mendime të mia personale.

Përfundova shkollën e mesme me rezultat që mjaftonte për ta regjistruar fakultetin. Së fundi, m'u realizua ëndrra që shpresoja tash sa kohë. Së fundi, tashmë unë do të kem mendimet e mia personale dhe nuk do të preokupohem me qëndrimet e të tjerëve!

Filloi viti shkollor dhe unë po kërkoja shoqe, të cilat do t'më shkëmbejnë të njëjtat ndjenja dhe përjetojnë të njëjtat preokupime. Me një fjalë, të ashtuquajtura femra të kohës dhe civilizimit, që kërkojnë të njetën liri sikurse unë.

U njoftova me disa shoqe dhe lidha me to shoqëri të ngushtë. Bisedat tona gjithnjë përfshinin çështje të kota, që nuk kishin vlerë: Rreth modës, kozmetikës, kanaleve satelitore, filmave, telenovelave, këngëve me videoklipat më të fundit... thashethëme, përgojime, shpifje, shaka dhe përqeshje dhe shumë punë të këtij lloji.

Në shtëpi, babai ishte i zënë me tregti, vëllezërit të gjithë kishin punët e tyre. Nuk dëgjoja asnjëherë nga ata ndonjë fjalë t'më këshillonin apo ndonjë vërejtje. Jetoja në një botë tërësisht tjetër ku vetë e ndërtova për vete, e që nuk kisha dëshirë të ndahem nga ajo. Unë asnjëherë nuk bëja ndonjë vepër të ligë sa isha e shoqëruar me shoqet e kolegët e mi (së paku ashtu mu dukte mua).

Një ditë, duke pritur autobusin tek dyert e univerzitetit ja, po me drejtohet një vajzë. Nga forma u dukeshte se kishte të njëjtat bindje dhe zakone ashtu siç i kishte nëna dhe gjyshja ime, e mbuluar tërësisht saqë nuk u shifte asgjë nga ajo. Më përshëndeti dhe zgjati dorën e mbuluar me dorëza drejt meje. Dhe unë ia zgjata dorën dhe e tërhoqa më shpejtësi. I thashë:

-Sikur kërkon diç nga unë?

-Tha: Në realitet oj motër, ajo që më tërhoqi shikimin tek ty ishte mantili yt. Desha të pyes për modelin e tij.

U çlirova dhe i thashë:

-Është model francez. Është modeli më i ri që ka zbritur në treg deri më tani!

Tha:

-A të shkon mendja se stilisti i këtij mantili nga Franca e bëri mbi parimet

valide që vlejnë për muslimanët?

I thashë:

-Për cilat parime e ke fjalën?

Më tha:

-A nuk e din se hixhabi (mbulesa fetare) ka disa kushte: Ta përfshijë tërë trupin, të mos jetë stoli që tërheqë shikimin, të jetë i trashë e të mos jetë i tejdukshëm, të jetë i gjërë e jo i ngushtë për trup, të mos jetë i ngajshëm me rrobat e meshkujve, e as me rrobat e pabesimtareve, të mos jetë i modernizuar. Ndërsa, mantili yt siç e sheh edhe vet, nuk plotëson shumicën e këtyre parimeve fetare. Është përplot me dekorime, është i ngushtë e gjithashtu edhe i tejdukshëm. Madje, i gjason rrobave të pabesimtarëve. Ty të shihen duart dhe krahët.

I thashë:

-Mjaft më!... mjaft! Mjafton me kaq. Ju gjithëmonë bazoheni në mendimet ekstreme. Ka plot dijetarë, të cilët e kanë lejuar të vishen mantile të tilla.

Tha:

-Problemi, oj motër, nuk qëndron se ç'thotë filani apo filani. Realiteti nuk njihet me persona. Nga çdokush mirret dhe refuzohet diçka përveç nga Pejgamberi [salallahu alejhi ve sel-lem] që nuk guxohet të refuzohet diç nga ai.

Pejgamberi [salallahu alejhi ve sel-lem] ka thënë:

"Dy lloje të njerëve janë nga banorët e zjarrit që ende nuk i kam parë: Njerëz që kanë kamzhikë që dukën si bishtat e lopëve e me to i rrahin njerëzit dhe gra të mbuluara, por (në fakt) të zbuluara, tërheqëse dhe provokative, nuk do të hyjnë në Xhennet e as do ta shijojnë aromën e tij edhe pse aroma e tij ndihet nga një distancë e largët".

Dijetarët kanë thënë se ajo që vesh mantile të llojit që ti ke të veshur llogaritet prej grupit të dytë, që përmendet në këtë hadith.

Gjithashtu Pejgamberi [salallahu alejhi ve sel-lem] ka thënë: *"Cilado femër që parfumosez dhe pastaj del për në xhami nuk i pranohet namazi derisa të pastrohët (dhe të largojë aromën që ka vënduar)".*

Ky parfumi yt i këndshëm më tërhoqi mua drejt teje e si qëndron puna me djelmoshat dhe burrat?! Oj motër, hixhabi-mbulesa është mbrojtje e nderit, pastërti, mbiron nga sytë e vjedhësve të nderit, që lakmojnë atë që nuk u është lejuar. Oj motër... (dhe këtu ia ndërpreva fjalët):

-Mjaft më!... mjaft! Përfundoi çdo gjë. Do të kërkoj sqarim për këtë çështje në të ardhmen. Pastaj u largova nga ajo.

Nuk u ndikova shumë nga ky takim.

Një ditë tjetër, isha e ulur në një kafiteri me koleget e mia. Siç e kishim zakon, të zgjerohemi në bisedat tona e të qeshnim me zë të lartë. Dhe më tepër se kjo, kishim dhe një kasetofon, që e kishim marrë për të dëgjuar këngë shurdhuese që tek ne ishin këngët më të dashura. Kësaj here me gjasë se zëri i kasetofonit ishte shumë i lartë.

Në këto çaste, po vinte drejt nesh një vajzë, na përshëndeti me selam dhe kërkoi nga ne që t'ia ulim zërin kasetofonit që të kishte mundësi të fliste me ne. Ashtu edhe vepruam.

Ishte një vajzë shumë e bukur, rrobat e saja tregonin një hijeshi dhe krenari edhe pse ajo ishte e mbuluar tërësisht. Por, rrobat që kishte përmbanin një kombinim të mirë ngjyrash dhe i rrinin në trup ashtu siç i takon një muslimaneje.

Pritja çastin të flasë kjo vajzë, e cila më mahniti shumë me bukurinë dhe veshjen e saj.

Dhe ia filloi... U bë e dyta që po na qortonte që po dëgjojmë këngë. Na këshilloi që më mirë të dëgjojmë Kur'an dhe kaseta të dobishme islame.

U habita nga kjo vajzë fantastike dhe gjithashtu bashkohore të na flasë për këso çështje. Por, kësaj here vendosa që të kem në konsideratë me

tepër dhe të kërkoj njohuri më tepër për mësimet fetare "të moçme".

I thashë asaj:

-Ndonjëherë, edhe ne dëgjojmë Kur'an, por kjo s'do të thotë që ne mos të kënaqemi edhe me ndonjë pikë muzikore.

Tha:

-Këtu ka shumë pengesa, Kur'ani dhe muzika nuk ka mundësi të bashkohen në një zemër. Madje, po qe se ndonjëra triumfon në zemër nuk ka vend për tjetrën!

I thashë:

-Ky është mendimi yt personal, dhe nuk është e udhës që mendimet e tua t'ua imponosh të tjerëve. Ne, e dojmë Kur'anin dhe gjithashtu e dojmë edhe muzikën.

Tha:

-Që t'ua vërtetohet atë që thashë dua të më tregojë cilado nga ju: Kur është hera e fundit që keni kërkuar ndonjë valë të radios që lëshon lexime nga Kur'ani Fisnik për të dëgjuar atë?

Mbetëm të hutuara, asnjëra nga ne nuk e hapi gojën. Mbeti vetëm të ngritnim zërin e kokëfortësisë dhe mashtrimit mes nesh. Njëra nga ne i tha:

-Nuk të ka mbetur ty që të na llogaritësh veprat tona. Ne nuk jemi në fakultet fetar, e të na drejtohes me këso lloj këshillash.

Tha:

-Se mos vallë mësimet e Islamit janë vetëm për studentët e fakulteteve të Sherijatis islam? Dhe të tjerët le të veprojnë ç'të dojnë?

I thashë:

-Jo...jo. Ajo nuk patë këtë për qëllim. Por, deshi të thotë se muzika nuk është haram. Pra, nuk ka ndonjë argument që ndalon muzikën.

Tha:

-Gjithsesi ka, madje argumente të shumta. Prej tyre fjala e All-llahut [subhanehu ve tea'a]: **"Po ka nga njerëzit që blenë tregime boshe e me qëllim që t'i largojnë njerëzit prej rrugës se All-llahut pa pasur kurrfarë fakti dhe për t'i marrë ato (ajetet e) All-llahut si tallje. Për ta me siguri është përgatitur dënim i turpshëm"** (Llukman, 6)

Ibën Mes'udi ka thënë se fjala e All-llahut: **"tregime boshe"** (Lehel-hadithi) ka për qëllim muzikën.

Gjithashtu Pejgamberi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] ka thënë: *"Do të vijë një kohë për ummetin tim, ku do bëjnë hallall amoralitetin, mëndafshin, verën dhe muzikën"*. Fjale El-Meazif në hadith është kënga dhe muzika.

Kur e panë kolegët e mia se nuk ia dilnin dot, foli njëra prej tyre:

-Lëreni bisedën me këto fetare! Pastaj iu drejtua asaj dhe i tha:

-Na ke ndërperë bisedën, e shoh se këshillat tua kanë përfunduar. Na lerë tani dhe vazho punët tua!

Tha:

-Më falni që ua ndërpreva bisedën! Por edhe diçka, mos harroni se kjo që ju bëni është në kundërshtim edhe me rregullat e fakultetit tuaj! Pastaj kërkoi ndjesë dhe u largua.

Nuk desha të ballafaqohesha me këtë vajzë në këtë formë të dialogut të fuqishëm që me argumentet e saja e nxjerrë në shesh dobësinë tonë. Pata dëshirë që gjatë dialogut ta bindi me qëndrimin tim se muzika nuk është haram. Por, si kam mundësi këtë kur ajo argumentohet me ajete kur'anore dhe hadithe që flasin për ndalimin e muzikës?!

Pasi që vajza shkoi, zgjati dorën njëra nga shoqet e mia për t'ia ngritur përsëri zërin e muzikës ashtu siç ishte dhe përsëri zbrërthyen të qeshurat.

Pas disa ditëve, më takoi kjo vajzë në fakultet. Erdhi tek unë dhe më përshëndeti. Deshi të kërkojë ndjesë, por ia prita unë e para dhe i kërkova falje për atë që ndodhi me shoqet e mia. Mes bisedës kuptova se ajo mëson në të njëjtin drejtim që jam edhe unë, u habita nga kjo dhe i thashë:

-Unë të kam llogaritur se ti mëson në ndonjë nga univerzitetët fetare.

Më tha:
-Përse?
I thashë:
-Nga interesi yt i madh për mësimet fetare. A nuk të pëngon kjo nga mësimet në fakultet?

Tha:
-Assesi! Unë e programoj kohën. Jeta ime fetare ma shtoi shumë kujdesin ndaj kohës dhe rëndësinë e saj. Ngaqë ra fjala, unë e flasë mirë gjuhën angleze dhe njoh mirë lëndën e informatikës. Këto dy janë çështjet më të rëndësishme në degët tona. E ndonjëherë ua spjegoj disa mësimet studenteve. Edhe ti, po të kesh nevojë diçka unë jam e gatshme të të ndihmoj.

Nga këtu, e shikoja atë me habi dhe para syve të mi shikoja një vajzë me vlerë të madhe. Kurse vetja mu bë shumë e vogël. Ajo spjegon mësimet nga gjuha angleze dhe nga informatika, kurse ne humbim kohën duke qeshur e duke dëgjuar muzikë. A mos vallë ky është civilizimi, të cilin e ëndërrova?!

Për një çast ndjeva se kjo vajzë po shpreh interesim për mua personalisht, sikur dëshiron të lidhë shoqëri me mua. Por, si të lidhë shoqëri me te e ajo gjithmonë flet për hallallin dhe haramin e kjo ma kujton kohën kur unë isha nxënëse e shkollës fillore apo e gjimnazit. Po ç'më duhet kjo punë mua. Këta ekstremistë, nuk e dinë se koha ka ndryshuar dhe njeriu patjetër duhet t'i përshtatet kohës në të cilën jeton...

Mjaft më me këto përralla të vjetra: Civilizim... qytetërim... përparim... Ky civilizimi që bëjmë ne nuk është tjetër vetëm duke veshur pantalone te ngushta, bluza të hapura, këpucë meshkujsh dhe duke lyrë fytyrën sikur fytyrat e akrobatëve. Kurse ajo spjegon në gjuhën angleze dhe nga informatika. Vërtetë, ajo është më qytetare se unë e gjithashtu edhe besimtare e mirë që në hollësi i njeh mesimet e fesë. I ka bashkuar dy të mirat.

Ç'është kjo që them?! A mos u ndikova nga kjo vajzë deri në këtë gradë?! Ku shkuan mendimet e mia të mëparshme, qëndrimet e mia personale dhe civilizimi, i cili pandalur e kërkoi?

Jo...jo. Duhet që të largohem nga kjo vajzë të mos ma turbullojë jetën. Shpresoja që kurrë më mos ta shihja e as ajo mua. E çdo herë që e vëreja nga larg merrja rrugë tjetër që mos të më shohë. Kurse raportet me kolegët e mia vazhduan ashtu si më parë. Ndërsa imazhi i asaj vajze, serioziteti, kultura dhe qytetërimi i saj gjithnjë rrinin në kujtesën time.

Erdhi koha të realizohet e vërteta. U sëmura rëndë dhe mu desht të shtrohem në spital ku aty duhej të qëndroja një kohë të gjatë. Më mori malli shumë t'i shoh koleget e mia e të marr ndonjë lajm nga univerziteti dhe për mësimet, të cilat më kanë humbur.

Pas një jave, më erdhi njëra nga ato dhe me lajmëroi se shoqet tjera kërkojnë ndjesë se nuk kishin mundësi të vinin edhe ato për vizitë. Nga ajo kërkoja që t'mi fotokopjojë ligjëratat, që nuk prezantova. Më premtoi se do ta bënte këtë. I pritja pa durim këto ligjëratat, por asnjëra nga ato nuk më erdhën. Kujtoja, ç'vlerë ka shoqëria kur nuk ka fryta në kohët më të vështira?! A nuk nijfet shoku i mirë në ditën e vështirë?! Vazhdoja të pres gjithë javën tjetër, por më kot.

Pas dy ditësh, më lajmëruan se jashtë ishte një vajzë, që dëshironte të më takojë. Patjetër thashë kjo duhet të jetë njëra nga kolegët e mia, e cila do të ketë ardhur të m'i sjellë ligjëratat siç i kisha kërkuar. Kërkoja nga motra medicinale që ta lejonte të hyjë brenda.

Në derë hyri vajza, me të cilën polemizua tek hyrja e univerzitetit rreth çështjes së hixhabit-mbulesës. U befasova me vizitën e saj! Si e mori vesh se unë jam sëmurë dhe jam shtruar në spital?! Kur e hoqi perçën (petkun që mbulonte fytyrën) dhe u ul pranë meje e kuptova se ajo është mu ajo vajza që na këshilloi tek kafiteria. Ajo vajzë që mëson me mua në të njëjtën degë. Ajo që u mahnitua me bukurinë e saj, qytetërimin e saj, precizitetin që kishte në robat e saja dhe me personalitetin e saj të lartë.

Gati se nuk besoja se kjo vajzë e civilizuar me këto rroba që mbulon tërë trupin qëndron përballë meje. I thashë:

-Tije ajo?

Tha:

-Po. I pyeta shoqet tua për ty dhe më lajmëruan për sëmundjen tënde. Kërkoja nga ato që të më japin emrin e spitalit dhe numrin e dhomës që të vijë e të vizitoj. E pa dyshim se për atë që viziton të sëmurin ka shpërblim të madh.

I thashë:

-Në relalitet, nuk di se si të falënderoj për këto ndjenja të ngrohta. Përveç kësaj, dua të kërkoj falje për çdo gjë që ka ndodhur nga unë.

Më tha:

-Mos u ngushto nga kjo. Më e rëndësishmja është që ti të shërohesh, sepse koha e provimeve është afruar shumë. Pastaj, nga çanta e saj nxori disa fletë dhe tha:

-Këtu i ke të gjitha ligjëratat që të kanë humbur. E në fund të çdo mësimi do të gleshë përmbledhjen e mësimin në pika të shkurta. E unë gjithashtu, inshallah do të vizitoj pas një jave që t'i sjellë ligjëratat e reja.

Këtu nuk munda t'a mbajë veten nga lotët. Kujtova ashpërsinë dhe kundërvimin tim ndaj saj tek hyrja e kafiterisë. Pas gjithë kësaj ajo sillte me mua me butësi, dashuri dhe afrim!

Gjithashtu, kujtova koleget e mia, të cilat u bënë koprace të vijnë e të më shohin në spital apo së paku të më telefonojnë.

Këtu m'u ndryshuan të gjitha mendimet dhe imagjinatat që kisha për civilizimin, progresin dhe bashkëkohoren.

Tash e kuptova se civilizimi nuk realizohet duke u larguar nga veprat virtyte dhe duke u shmangur gjesteve dhe parimeve të dobishme.

Tash e kuptova se bashkëkohorja nuk realizohet duke injoruar fenë dhe moralin dhe duke këmbngulur në mendimet dhe kulturat e pavlera.

Tash e kuptova se përparim është atëherë kur merr pjesë në dhimbjet e të tjerëve, iu ndihmon atyre dhe ua lehtëson atyre dhimbjet.

Tash e kuptova se Islami i ka dhuruar femrës civilizimin dhe i ka dhënë asaj të drejta, me të cilat mund të çojë një jetë të shkëlqyer nën hijën e mësimëve të shëndoshta.

I thashë:

-Prej tani po shpall dështimin tim. E kam vendosur që nga ky çast t'i jap jetës sime kahje tjetër, duke u përputhur me Ligjin e All-llahut (subhanehu ve te'ala), që të jem vajzë e mirë sikur ti...

Iu ndriçua fytyra nga një buzëqeshje e ngrohtë dhe tha:

-Oj motër, marrëdhëniet tona nuk kishin kuptim të dyluftimit. E rëndësishmja është që ne të arrijmë të gjithë tek mirësia e sigurtë, të triumfojmë me të vërtetën dhe të arrijmë lumturinë e gjithëhershme.

Thashë:-Po, vëretët kjo është e rëndësishme...

On-line versionin e këtij teksti mund ta gjeni në:

www.ankebut.com

Pasi të lexoni këtë broshurë, mundësojani të tjerëve të lexojnë të njëjtën. Dhe keni kujdes, fletushka përmban ajete kur'anore, andaj ndalohet hyrja me të në vende të ndotura, gjegjësisht në toalet si dhe në vende të ngjashme.

Boton:

Shoqata Qytetare
Klubi Studentor

e-mail: penastudentore@hotmail.com

